



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TE MENAXHIMIT FINANCIAR,
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 5748 Prot.

Tiranë, më 14 /2019

URDHËR

Nr. 117, Datë 14 2019

**“PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR
MONITORIMIN E PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË NJËSIVE PUBLIKE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe bazuar në nenet: 6 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë “Për Monitorimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësive Publike” bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Qëllimi i këtij dokumenti është:
 - a. Përshkrimi i procesit të vlerësimit dhe monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive të qeverisjes së përgjithshme nga ana e strukturave përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat;
 - b. Përshkrimi i metodologjisë standarde që ndjekin titullarët në kuadër të monitorimit vjetor të sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit që drejtojnë.
3. Strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat që ngarkohen me vlerësimin dhe matjen e treguesve të monitorimit të performancës së njësive publike janë:
 - a. Struktura përgjegjëse për buxhetin;
 - b. Struktura përgjegjëse për thesarin;
 - c. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik.

4. Ngarkohet struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për përpunimin e informacionit të konsoliduar dhe paraqitur sipas kërkesave të metodologjisë bashkëlidhur si dhe hartimin e raportit përfundimtar brenda muajit Maj të çdo viti.
5. Informacioni përfundimtar është pjesë përbërëse e raportit vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik.
6. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Njësive Publike”, shfuqizohet.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Anila Denaj



**METODOLOGJIA
PËR
MONITORIMIN E PERFORMANCËS
SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË NJËSIVE PUBLIKE**

Tabela e Përmbajtjes

I. Të përgjithshme	2
II. Monitorimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike nga ministria përgjegjëse për financat.....	2
i. Përgjegjësitë e strukturave të ministrisë përgjegjëse për financat në procesin e monitorimit 3	
ii. Afatet e raportimit dhe hartimit të raportit vjetor.....	3
III. Monitorimi nga ana e drejtuesve të njësive publike të performancës së njësive/strukturave që drejtojnë.....	4
IV. Treguesit e performancës	5
V. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave.....	25
Aneksi 1. Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik.....	
Aneksi 2. Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e varësisë të sektorit publik.....	
Aneksi 3. Pyetësi i vetëvlerësimit për njësitë e auditimit të brendshëm.....	

I. Të përgjithshme

1. Qëllimi i këtij dokumenti është përshkrimi i metodologjisë standarde që ndjek ministria përgjegjëse për financat dhe strukturat e saj të përfshira në këtë proces në kuadër të monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike mbi bazë performance.
2. Kjo metodologji mund të përdoret nga drejtuesit e njësive publike për monitorimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive/strukturave që drejtojnë në përmbushje të objektivave dhe misionit të institucionit.
3. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të institucionit, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, Titullari i njësisë, Nëpunësi Autorizues dhe drejtuesit e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së sistemit të menaxhimit financiar dhe realizimit me eficiencë, efektivitet dhe ekonomi të shpenzimeve buxhetore në përputhje me objektivat sipas programeve dhe produkteve të planifikuara për çdo program gjatë një viti buxhetor.
4. Për këtë qëllim janë identifikuar treguesit kryesorë të performancës që do të mundësojnë monitorimin e duhur, si dhe është përcaktuar mënyra e matjes së tyre.
5. Metodologjia e monitorimit të performancës së njësive publike, bazohet në tregues të kombinuar që ndihmojnë për të krijuar opinionin mbi performancën e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
6. Vlerësimi i performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm realizohet edhe nëpërmjet Pyetësorit të Vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) bazuar në shtatëmbëdhjetë parime gjithëpërfshirëse, të depozituara çdo vit në ministrinë përgjegjëse për financat. (Aneksi 1 bashkëlidhur këtij Urdhri)

II. Monitorimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike nga ministria përgjegjëse për financat

Ministri përgjegjës për financat është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.

Ministri përgjegjës për financat, brenda muajit Maj të çdo viti, paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvend, raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Ky raport përmban informacion në lidhje me arritjet nëpërmjet buxhetit për vitin buxhetor përkatës duke përfshirë këtu edhe performancën e produkteve në sasi dhe në vlerë në krahasim me planifikimin si dhe duke identifikuar arritjet dhe problemet e hasura gjatë menaxhimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, i bashkëngjitet dhe raporti i vlerësimit vjetor të situatës së sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në kuadër të realizimit të përgjegjësisë si më lartë, ministri përgjegjës për financat duhet të kryejë një monitorim të vazhdueshëm të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, për të dhënë siguri të arsyeshme që fondet publike përdoren me ekonomi, eficiencë dhe efektivitet.

i. Përgjegjësitë e strukturave të ministrisë përgjegjëse për financat në procesin e monitorimit

1. Nëpunësi i Parë Autorizues (NPA) jep llogari përpara Ministrinë përgjegjëse për financat për monitorimin e realizuar gjatë procesit të zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe për monitorimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
2. Struktura përgjegjëse për buxhetin në ministrinë përgjegjëse për financat, analizon dhe vlerëson raportet e sintetizuara periodike të monitorimit të njërive të qeverisjes qendrore dhe përgatit një raport me konkluzione dhe rekomandime për secilën njësi të qeverisjes qendrore për periudhën përkatëse të raportimit. Mbështetur në informacionin e raporteve të sintetizuara të monitorimit, struktura përgjegjëse për buxhetin i rekomandon NPA të marrë masat e nevojshme korrigjuese për menaxhimin e buxhetit, në rastet kur identifikohen devijime nga planifikimi.
3. Struktura përgjegjëse për thesarin në ministrinë përgjegjëse për financat, kryen funksionet e kontrollit financiar të transaksioneve para pagesës, menaxhimin e likuiditeteve të qeverisë gjatë procesit të kryerjes së transaksioneve financiare, si dhe përgatit raporte të sintetizuara për çdo institucion qendror dhe vendor.
4. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, nëpërmjet:
 - a. strukturës përgjegjëse të harmonizimit të menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit (MFKK), monitoron në nivel vjetor cilësinë e sistemeve të MFK për njësitë publike. Ky monitorim kryhet nëpërmjet analizës së përgjigjeve të pyetësorëve vjetorë të vetëvlerësimit të sistemeve, si dhe monitorimit në vend të njërive publike mbi bazën dokumentare të MFK-së. Gjithashtu, ky monitorim vjetor merr në konsideratë nevojat për trajnim të drejtuesve dhe problematikat e ngritura nga titullarët apo drejtuesit e tjerë të njërive publike.
 - b. Struktura përgjegjëse e harmonizimit të auditimit të brendshëm, monitoron në nivel vjetor funksionimin e veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm (AB) në sektorin publik. Ky monitorim kryhet nëpërmjet analizës së raporteve vjetore të njërive të auditimit të brendshëm (NJAB) (raporte, evidenca dhe pyetësorët e vetëvlerësimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm), të cilat depozitohen çdo fillim viti pranë kësaj strukture, analizës së procesit vjetor të certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm si dhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë i realizuar pranë NJAB-ve në sektorin publik gjatë një viti.

ii. Afatet e raportimit dhe hartimit të raportit vjetor

1. Strukturat përgjegjëse për buxhetin dhe thesarin dërgojnë brenda muajit Shkurt të çdo viti, raportet e sintetizuara vjetore specifike dhe një relacion shpjegues për të dhënat të raportuara, për treguesit përkatës të performancës, tek struktura përgjegjëse e harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, e cila konsolidon informacionin dhe harton raportin vjetor të konsoliduar për cilësinë dhe funksionimin

e sistemit të kontrollit të brendshëm brenda muajit Maj të çdo viti. Raporti vjetor i konsoliduar për kontrollin e brendshëm, hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument dhe për çdo njësi qendrore apo vendore të monitoruar gjatë vitit, p.sh. për njësitë qendrore raportet që dorëzohen duhet të paraqiten të konsoliduara, i cili përfaqësohet nga mesatarja e pikëve të të gjithë sistemit (njësi qendrore + njësitë e varësisë), ndërsa për njësitë vendore do të jetë mesatarja e pikëve të njësisë: Bashki/Këshill qarku (aparaturë vendor + njësitë e varësisë). Raporti vjetor i konsoliduar shoqërohet me renditjen e performancës së njësive publike, bazuar në vlerësimin e treguesve përkatës të strukturës përgjegjëse për buxhetin, thesarin dhe kontrollin e brendshëm financiar publik, ku identifikohen dhe njësitë publike me performancë më të lartë. Ky raport i dërgohet NPA për raportim tek ministri përgjegjës për financat.

2. Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit vjetor paraqiten në seancat dëgjimore të fazës strategjike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, që organizohen në ministrinë përgjegjëse për financat, me secilën njësi të qeverisjes qendrore, sipas afateve të përcaktuara çdo vit në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, i cili miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-në, në cilësinë e Sekretariatit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, paraqet problematikat e ndryshme të njësive publike, të cilat diskutohen në mbledhjet e këtij bordi dhe në vijim rezultatet e analizës së performancës së njësive publike, të shoqëruara me rekomandimet përkatëse, i dërgohen titullarëve respektive së njësive publike.

III. Monitorimi nga ana e drejtuesve të njësive publike të performancës së njësive/strukturave që drejtojnë

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë që mbulon, për performancën e produkteve të identifikuara në programin buxhetor afatmesëm, si dhe produktet për të cilat janë alokuar fondet buxhetore me buxhetin vjetor përkatës. Në këtë kuadër, ai/ajo duhet të monitorojë realizimin e objektivave nëpërmjet garantimit të një sistemi të brendshëm funksional të mbikëqyrjes dhe raportimit për matjen e performancës së veprimtarisë së njësisë dhe vlerësimin e efektivitetit të sistemit të MFK-së.

Nëpunësi Autorizues është përgjegjës dhe raporton tek Titullari për zbatimin e buxhetit vjetor dhe cilësinë e funksionimit të sistemit të MFK-së në të gjitha strukturat dhe programet/aktivitetet buxhetore, duke përfshirë monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë publike.

Mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari, përgjegjësitë për monitorimin e performancës duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues tek drejtuesit e niveleve të tjera të njësisë publike.

Çdo njësi publike mund të kryejë vetë monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm për një periudhë të caktuar ose në nivel vjetor, duke konsoliduar të dhënat e mbledhura sipas treguesve të kësaj metodologjie apo për çdo tregues performancë që konsiderohet i rëndësishëm për nga specifika e njësisë publike. Të dhënat duhet të përfshijnë të gjithë veprimtarinë e njësisë publike duke konsideruar edhe veprimtarinë e njësive të varësisë.

Gjithashtu, pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së, është konceptuar të përdoret nga njësitë publike për vetëvlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Pyetësori përbëhet nga pesë seksione që i përgjigjen respektivisht komponentëve të MFK-së, sipas standardeve ndërkombëtare COSO, ku komponentët përfshijnë gjithsecili, disa parime specifike. Për secilin parim janë ndërtuar një grup pyetjesh, bashkëlidhur të cilave do të jepet një përgjigje e arsyetuar dhe e justifikuar nëpërmjet paraqitjes së evidencave mbështetëse.

Nën drejtimin dhe koordinimin e Nëpunësit Autorizues, rezultatet e konsoliduara të monitorimit të performancës i vihen në dijeni Titullarit të njësisë publike.

IV. Treguesit e performancës

Treguesit e performancës janë mjete matëse sasiore dhe cilësore që shërbejnë për të treguar ecurinë e njësisë publike në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale. Ato vlerësojnë suksesin e një njësie publike ose të një aktiviteti të caktuar (siç janë projektet, programet, produktet dhe iniciativat e tjera) në të cilat kjo njësi angazhohet. Gjithashtu, këto tregues përdoren për të krahasuar situatën financiare dhe performancën ndërmjet njësisë të sektorit publik.

Në këtë kontekst, ato masin ndikimin, efektet, rezultatet dhe përfundimet e procesit të vlerësimit të performancës. Procesi i identifikimit apo përcaktimit të treguesve i shërben dy qëllimeve kryesore:

- 1) **Ndihmon në sqarimin e objektivave**, si dhe në përcaktimin e aktiviteteve dhe hapave të nevojshëm për përmbushjen e objektivave. Për të zgjedhur treguesit, drejtuesit duhet të konsiderojnë se cilët matës të ecurisë prezantojnë më mirë përmbushjen e objektivave të institucionit/programit buxhetor/drejtorisë, duke kontribuar anasjelltas në një përcaktim më të mirë dhe më specifik të objektivave.
- 2) **Ndihmon procesin e monitorimit**. Monitorimi do të ndihmojë në lidhje me zbatimin e aktiviteteve, arritjen e rezultateve, menaxhimin e risqeve, shpenzimet dhe përdorimin e burimeve. Monitorimi nënkupton:
 - a. Mbledhjen sistematike dhe të vazhdueshme të informacionit;
 - b. Analizimin e informacionit;
 - c. Përdorimin e tij në procesin e vendimmarrjes.

Monitorimi shërben në marrjen e masave korrigjuese dhe ndihmon në përditësimin e planit të veprimit, duke ndihmuar për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të të gjithë procesit.

Për çdo objektiv përcaktohet një ose më shumë tregues performance që masin rezultatin e lidhur me këtë objektiv.

Është e qartë se për t'i shërbyer sa më mirë qëllimit për të cilin përdoren, treguesit duhet të plotësojnë një sërë kushtesh të tjera, ndër të cilët:

- a. Të jenë specifik;
- b. Të jenë të matshëm;
- c. Të arritshëm;
- d. Realistë;
- e. Me afat të përcaktuar.

Analizimi i këtyre treguesve do të përfshijë:

- a. Përshkrimin e treguesit;
- b. Njësine matëse;
- c. Si duhet të matet në praktikë.

Kjo metodologji përfshin dy grupe treguesish performance që i korrespondojnë përkatësisht planifikimit, zbatimit dhe ekzekutimit të buxhetit ku përgjegjës për gjenerimin e të dhënave janë respektivisht struktura përgjegjëse për buxhetin dhe struktura përgjegjëse për thesarin, si edhe treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilët mundësohen nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik. Për secilin tregues përfshihen elementet e mëposhtëm:

- Burimi i informacionit (të dhënave) që shërben si bazë e matjes së treguesit;
- Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për matjen e treguesit (dhe sigurimin e informacionit për qëllime raportimi/monitorimi). Kjo përgjegjësi e caktuar përfshin gjithashtu llogaridhënien për vlefshmërinë /cilësinë e të dhënave;
- Frekuenca e publikimit të të dhënave (dhe/ose mbledhjes së të dhënave);
- Një përshkrim metodologjik i metodës së matjes.

Treguesit për planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit

1. Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve buxhetore (në %)		
	Ky tregues përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi/Këshilli Bashkiak.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ)		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca PEFA	PI-1		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Realizimi i shpenzimeve buxhetore/shpenzimet buxhetore të miratuara në Kuvend/Këshill Bashkiak	96%-100%	4
		91%-95%	3
		86%-90%	2
		50%-85%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues do të llogaritet si raport i realizimit të shpenzimeve buxhetore me shpenzimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi/Këshilli Bashkiak.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 50%-85%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 86%-90%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 91%-95%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 96%-100%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>		

2. Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në %)
	Ky tregues mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik.

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga SIFQ		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca PEFA	PI-2		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Devijimi total/Buxheti total i miratuar	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues do të llogaritet si raport i diferencës midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik me buxhetin total të miratuar në Kuvend/Këshillin Bashkiak.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>		

Baza për llogaritjen e treguesit sipas klasifikimit ekonomik:

Për çdo institucion	Buxheti i miratuar në Kuvend/Këshillin Bashkiak	Buxheti faktik	Devijimi	%
Pagat				
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore				
Mallra dhe Shërbime				
Subveccionet				

Të tjera transferta korrente të brendshme				
Transferta korrente të huaja				
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët				
Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara				
Shpenzime Kapitale të Trupëzuara				
Totali	Buxheti total i miratuar		Raporti i devijimit total	Devijimi total/ totali i buxhetit të miratuar

3. Treguesi i Performancës	Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura		
	Niveli i reduktimit të detyrimeve të prapambetura shprehet si diferencë e stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12-mujor të vitit paraardhës		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga raportet vjetore		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin dhe struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca PEFA	PI-22		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Diferenca e stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12-mujor të vitit paraardhës	<-20%	4
		-20% -0%	3
		0% -20%	2
		>20%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues llogaritet si diferenca e stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12-mujor të vitit paraardhës. Në rastet kur treguesi		

	<p>është pozitiv tregon që institucionet rezultojnë me stok të rritur të detyrimeve të prapambetura dhe madhësia e përqindjes tregon dhe nivelin e rritjes nga viti paraardhës në vitin korrent. Në rastet kur treguesi rezulton negativ kemi reduktim të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe madhësia e treguesit tregon nivelin e uljes së detyrimeve të prapambetura të institucionit.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) rezulton më e lartë se 20%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin nga 0% deri në 20%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin nga 0% deri në -20%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e lartë se -20%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

4. Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve kapitale		
	Treguesi mat devijimin midis shpenzimeve buxhetore kapitale të planifikuara dhe atyre faktike.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga SIFQ		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Pasaporta e Indikatorëve të SIGMA dhe Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Devijimi nga plani i realizimit i shpenzimeve kapitale në një vit/shpenzimet kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend/Këshillin Bashkiak	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues llogaritet si raport i shpenzimeve kapitale në një vit me shpenzimet kapitale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend/Këshillin Bashkiak. Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;		

	<p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

5. Treguesi i Performancës	Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit		
	Pjesa më e madhe e projekteve janë regjistruar bazuar në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga SIFQ dhe PBA		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: shuma totale e shpenzuar deri në periudhën e vlerësimit për projektet e investimeve (një ose disavjeçare) /shuma totale e planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet.	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1

Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i shumës totale të shpenzuar deri në periudhën e vlerësimit për projektet e investimeve (një ose disavjeçare) me shumën totale të planit shumëvjeçar të parashikuar.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>
---------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

6. Treguesi i Performancës	Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit		
	Treguesi duhet të masë pagesën në kohë të faturave të pranuar nga furnitori.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga SIFQ do të tregojë të gjitha faturat e paguara me një tregues të numrit të ditëve të kaluara nga data e faturave derisa të kryhet pagesa		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: numri i faturave të paguara pas 30 ditëve/numrin total të faturave	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i numrit të faturave të dërguara për pagesë pas afatit kohor prej 30 ditësh me numrin total të faturave të dërguara për pagesë.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p>		

	të jetë 3 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.
--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

7*. Treguesi i Performancës	Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)		
	Treguesi duhet të masë kontabilizimin brenda afatit kohor prej 30 ditësh në SIFQ të faturave të detyrimeve të prapambetura të lindura për shkak të mungesës së fondeve buxhetore apo planit mujor të arkës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë do të tregojë të gjitha faturat e kontabilizuara me një tregues të numrit të ditëve të kaluara nga data e kontabilizimit derisa të kryhet pagesa. Struktura përgjegjëse për IT / Procesimin e Biznesit me SIFQ do të gjenerojë nga baza e të dhënave raportin e faturave të detyrimeve të prapambetura, të dhënat e të cilit do të jenë të njëjta me ato të kontabilizuara në llogarinë 486 për të njëjtën periudhë.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Mujore		
Referenca	Ligji nr. 48/2014 “Për Pagesat e Vonuara në Detyrimet Kontraktore e Tregtare” dhe Udhëzimi nr. 8, datë 20.03.2018”, “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: numri i faturave të papaguara të kontabilizuara në llogarinë 486 (Librin e Madh të SIFQ), në të njëjtën datë me regjistrimin e faturës së paguar (në modul Account Payable të SIFQ) / numrin total të	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1

* Për vitin 2018 ky tregues do të llogaritet në bazë të tepricës kontabël të llogarisë ekonomike 486 që gjeneron SIFQ, e cila paraprakisht është konfirmuar nga institucionet e marra në analizë.
Për vitin 2019, ky tregues do të llogaritet sipas metodës së paraqitur në këtë tabelë, ku të dhënat do të krahasohen me raportin e gjeneruar nga Moduli “Account Payable”.

	faturave të papaguara të kontabilizuara (në Librin e Madh të SIFQ)		
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i numrit të faturave të dërguara për kontabilizimin e detyrimit të prapambetur si shpenzim i periudhave të ardhshme (llogaria 486) në të njëjtën datë me regjistrimin e faturës së paguar/ numrin total të faturave të kontabilizuara në llogarinë 486.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>		

8. Treguesi i Performancës	Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit		
	Treguesi mat nëse njësitë buxhetore i dorëzojnë kontratat në degët respektive të thesarit brenda tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga SIFQ do të tregojë të gjitha kontratat e nënshkruara brenda një viti kalendarik, datën e nënshkrimit të kontratës dhe datën e regjistrimit të kësaj kontrate në SIFQ		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: numri i kontratave të dërguara pranë degëve të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre/numrin total të kontratave	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1

Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i numrit të kontratave të dërguara në degën e thesarit pas 3 ditëve nga data e nënshkrimit të tyre me numrin total të kontratave.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>
---------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

9. Treguesi i Performancës	Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara		
	Treguesi mat numrin e urdhrave të prokurimeve të paautorizuara të dërguara në degët përkatëse të thesarit.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një dokument në Excel i përgatitur nga degët e thesarit do të tregojnë nëse ka prokurime të cilat kanë filluar të ekzekutohen pa konfirmimin paraprak të buxhetit nga ana e thesarit. Në dokument do të evidentohen shuma totale e urdhër prokurimeve dhe nëse ka një autorizim nga thesari		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara/shuma totale e urdhër prokurimeve të cilat janë dërguar për pagesë në degën e thesarit	<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i numrit të urdhër prokurimeve të paautorizuara me numrin total të urdhër prokurimeve të cilat janë dërguar për pagesë në degën e thesarit.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p>		

	<p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

10. Treguesi i Performancës	Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës		
	Treguesi mat vlerën e avancimeve nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një dokument në Excel i përgatitur nga struktura përgjegjëse për drejtimin e likuiditetit në qendër për qeverisjen qendrore dhe nga struktura përgjegjëse për Thesarin në degë për qeverisjen vendore		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Periodike		
Referenca	Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” për çeljen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të operatorëve ekonomikë dhe në vijim të tij udhëzimi plotësues i përvitshëm.		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Vlera e avancuar/ vlera vjetore e planit të arkës	<10%	4
		10%-11.99%	3
		12%-14.99%	2
		>15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues llogaritet si raport i vlerës së avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese me totalin e planit vjetor të arkës.</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e madhe se 15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 12%-14.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-11.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë;</p> <p>Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 10%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.</p>		

11. Treguesi i Performancës	Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi	
	Treguesi mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimin, përgatitjen dhe paraqitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme.	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore. Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> - Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore - Respektimi i afatit kohor ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare - Nënshkrimi i pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin ligjor 	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	Udhëzimi nr. 8, datë 20.03.2018”, “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për raportimin financiar mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret 	4
		3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të matet bazuar në analizimin me detaje të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe paraqitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore me qëllim përmirësimit e cilësisë së raportimit financiar në njësitet e qeverisjes së përgjithshme. Vlerësimi do të jetë përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> - 1 deri në 2 pikë për kriterin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore - 1 pikë për respektimin e afatit kohor ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare - 1 pikë për kriterin e nënshkrimin të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin ligjor 	

Treguesit e performancës të sistemeve të kontrollit të brendshëm

12. Treguesi i Performancës	Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	
	Treguesi mat respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Plani vjetor për ngritjen e sistemit të MFK-së i hartuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në përputhje me të gjitha mangësitë e evidentuara gjatë implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, do të shërbejnë për monitorimin e këtij treguesi edhe monitorimet e kryera në vend dhe raportet e AB-së dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> - Respektimi i afatit kohor për dorëzimin e Planit të Veprimit; - Aktivitetet e planifikuara për t'u ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të MFK dhe aktivitete për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së; - Aktivitete që ndërmerren për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e AB-së; - Aktivitete që ndërmerren për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e KLSH. 	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016”, “Për Koordinatorin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorin e Riskut në Njësitë Publike”	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e	4
		3
		2

	<p>MFKK-së mbi përmbushjen e kritereve të vlerësimit të treguesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret 	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të matet bazuar në analizimin me detaje të përmbushjes së kritereve ligjore dhe përmbajtjes cilësore të Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFKK-së lidhur me katër pikat e fokusit të sipërcituara. Vlerësimi do të jetë me 1 pikë për çdo kriter të përmbushur nga njësia publike.	

13. Treguesi i Performancës	Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	
	Raporti mbi zbatimin e kontrollit të brendshëm konsiderohet të jetë gjithëpërfshirës nëse përfshin statistika, informacion mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik dhe përfshin të gjitha njësitë e varësisë që kanë detyrimin ligjor për zbatimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Deklarata dhe Raporti për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të jetë hartuar me cilësi dhe depozitimi i tyre brenda afateve kohore të përcaktuara.	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	<i>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar</i>	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përmbushjen e kritereve të vlerësimit të treguesit. <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret 	4
		3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin dhe	

	<p>gjykimin profesional të specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përmbushjen e kritereve ligjore, përmbajtjen cilësore të Deklaratës dhe Raporti për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të cilin përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informacion mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike; - informacion i konsoliduar duke përfshirë të gjitha njësitë e varësisë (nëse ka). <p>Vlerësimi do të jetë përkatësisht me 1 deri në 3 pikë për cilësinë e paraqitjes dhe përmbajtjes së Deklaratës dhe Raportit për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe me 1 pikë për kriterin e respektimit të afatit kohor të depozitimit të këtyre dokumenteve.</p>
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

14. Treguesi i Performancës	<i>Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik</i>
	Ky tregues vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjësisë menaxheriale.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	<p>Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësonin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia publike ka miratuar një strukturë organizative të përshatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj; - Plani vjetor i punës i njësisë publike përmban objektiva specifike dhe objektiva të matshëm të miratuar nga titullari i njësisë dhe monitorohet të paktën një herë në vit; - Raportime vjetore mbi nivelin e rezultateve të arritura kundrejt objektivave dhe synimeve të paracaktuara; - Delegimi i autoritetit të vendimarrjes dhe kryerja e procedurave të delegimit sipas bazës ligjore në fuqi;
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar

		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejtë me elementët bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret 	4
		3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë lidhur me katër kriteret e sipërcituara. Vlerësimi do të jetë me 1 pikë për çdo kriter të përmbushur nga njësia publike.	

15. Treguesi i Performancës	Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB
	Ky tregues vlerëson nivelin e përputhshmërisë së NJAB-ve dhe audituesve të brendshëm me kriteret ligjore në lidhje me realizimin e shërbimit, me krijimin e NJAB-ve dhe me kapacitetet profesionale.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve. Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> - Njësia publike realizon shërbimin e AB-së; - NJAB është krijuar në përputhje me kërkesat ligjore (minimumi 3 auditues); - Drejtuesit e NJAB dhe audituesit e brendshëm plotësojnë kërkesat ligjore të punësimit; - Audituesit e Brendshëm certifikohen dhe ndjekin trajnimet e vijueshme profesionale në përputhje me kërkesat ligjore.
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore
Referenca	Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 83, datë

	03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së mbi informacionin e paraqitur në Raportet Vjetore të njësive të AB-së mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret; - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime; - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret; - Njësia nuk i plotëson kriteret. 	4
		3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues do të llogaritet nëpërmjet katër kriterëve të mësipërme. Për secilin kriter të përmbushur, NJAB-të vlerësohen me 0 ose me 1 pikë.</p> <p>Çdo NJAB mund të vlerësohet për këtë tregues me 0 pikë; 1 pikë; 2 pikë; 3 pikë ose 4 pikë, në varësi të kriterëve që plotëson.</p>	

16. Treguesi i Performancës	Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të
	Ky tregues vlerëson cilësinë e përgatitjes së planit strategjik dhe vjetor të NJAB-ve dhe në çfarë mase NJAB-të përmbushin kriteret e përgatitjes së këtij dokumenti.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	<p>Të dhënat do të nxirren nga Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB-ve. Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani strategjik dhe vjetor i përmbahet strukturës së përcaktuar në Manualin e AB-së dhe është paraqitur në afatet e përcaktuara në strukturën përgjegjëse për AB-në; - Plani strategjik dhe vjetor është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore (përfaqëson një univers gjithëpërfshirës dhe miratohet nga titullari); - Plani strategjik dhe vjetor është bazuar në vlerësimin e riskut që mbulon të gjitha sistemet e njësive publike;

	- Plani strategjik dhe vjetor ka parashikuar lloje të ndryshme auditimi (a.përputhshmërie, b. të kombinuar, c.performance, d. të fondeve të BE (nëse ka), etj.).	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së mbi informacionin e e planit strategjik dhe vjetor të njëjësive të auditimit të brendshëm dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. <ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret; - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime; - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret; - Njësia nuk i plotëson kriteret 	4
		3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet nëpërmjet katër kriterëve të mësipërme. Për secilin kriter të përmbushur, NJAB-të vlerësohen me 0 ose me 1 pikë. Çdo NJAB mund të vlerësohet nga 0 pikë; 1 pikë; 2 pikë; 3 pikë ose 4 pikë, në varësi të kriterëve që plotëson.	

17. Treguesi i Performancës	Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve
	Ky tregues vlerëson cilësinë e përgatitjes së Raportit Vjetor të NJAB-ve i cili dorëzohet në ministrinë përgjegjëse për financat dhe masën e përmbushjes së kriterëve të përgatitjes së këtij dokumenti nga NJAB-të.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve. Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon:

	<ul style="list-style-type: none"> - Raporti Vjetor i përmbahet strukturës së përcaktuar në Manualin e AB-së dhe është paraqitur në afatet e përcaktuara në strukturën përgjegjëse për harmoizmin e AB-së; - Raporti Vjetor përfshin analizën e gjetjeve dhe rekomandimeve të AB-së; - Raporti vjetor përfshin vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm; - Raporti Vjetor evidenton dobësitë dhe përcakton prioritetet të qarta për të ardhmen. 	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm	
	Pikëzimi	
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së mbi informacionin e raporteve vjetore të NJAB-ve dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit.	4
	<ul style="list-style-type: none"> - Njësia plotëson kriteret; - Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime; - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret; - Njësia nuk i plotëson kriteret. 	3
		2
		1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Ky tregues matet nëpërmjet katër kriterëve të mësipërme. Për secilin kriter të përmbushur, NJAB-të vlerësohen me 0 ose me 1 pikë.</p> <p>Çdo NJAB për këtë tregues mund të vlerësohet me 0 pikë; 1 pikë; 2 pikë; 3 pikë ose 4 pikë, në varësi të kriterëve që plotëson.</p>	
18. Treguesi i Performancës	Zbatimi i rekomandimeve të AB-së	
	Ky tregues vlerëson nivelin e zbatimit të rekomandimeve të AB-së nga subjektet e audituara.	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve, ku do analizohet niveli i zbatimit të rekomandimeve.	

Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm		
		%	Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së mbi informacionin e raporteve vjetore të NJAB dhe mbi përmbushjen e kritereve të vlerësimit të treguesit. - Raporti ndërmjet rekomandimeve të pranuar dhe rekomandimeve të zbatuara	>70%	4
		>60%	3
		>50%	2
		<50%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	<p>Çdo NJAB për këtë tregues mund të vlerësohet me 1 pikë; 2 pikë; 3 pikë ose 4 pikë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - NJAB që rezulton me më shumë se 70% e rekomandimeve të zbatuara vlerësohet me 4 pikë; - NJAB që rezulton me më shumë se 60% e rekomandimeve të zbatuara vlerësohet me 3 pikë; - NJAB që rezulton me më shumë se 50% e rekomandimeve të zbatuara vlerësohet me 2 pikë; - NJAB që rezulton me më pak se 50% e rekomandimeve të zbatuara vlerësohet me 1 pikë; 		

V. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave

Procesi i vlerësimit dhe monitorimit të performancës së njësive publike iniciohet nga një fazë e rëndësishme që është përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) ka rolin kryesor në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi treguesit e performancës për çdo njësi publike.

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e KBFP-së, brenda afateve kohore ligjore të përcaktuara njofton strukturat përgjegjëse brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

(strukturën përgjegjëse për buxhetin dhe strukturën përgjegjëse për thesarin) që gjenerojnë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e treguesve respektivë të performancës, të dërgojnë brenda muajit Shkurt të çdo viti, raportet e sintetizuara vjetore specifike dhe një relacion shpjegues për të dhënat statistikore të raportuara.

Të gjitha të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës, do të vlerësohen sipas kësaj metodologjie dhe sistemit të pikëzimit të përcaktuar. Në vazhdimësi, të dhënat do të përpunohen sipas sistemeve manuale të kombinuar me programe të thjeshta kompjuterike dhe do të shihet nëse ekziston mundësia e ndonjë mangësie apo gabimi në raportim, të cilat do t'ju dërgohen përsëri për verifikim strukturave përgjegjëse përkatëse.

Në fazën tjetër, do të kryhet analizimi i detajuar i të dhënave për të gjithë treguesit e performancës duke marrë në konsideratë përveç të dhënave të gjeneruara automatikisht nga sistemi i Buxhetit/Thesarit edhe vlerësimin dhe gjykimin profesional të specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e KBFP-së mbi përmbajtjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të dërguar.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të paraqiten në Raportin Vjetor të Konsoliduar mbi Funkionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme. Ky raport dhe gjetjet kryesore të tij do t'i prezantohen Këshillit të Ministrave dhe do të diskutohen në Parlament gjatë seancave të miratimit të buxhetit faktik.